

“Në zbatim të detyrimeve ligjore që vijnë nga ligji Nr. 9887 dt.10/03/2008 ndryshuar me ligjin Nr.48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” si dhe rekomandimeve të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë njofton të gjithë përdoruesit e web-it “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë”se:

Për të kërkuar informacion mbi një çështje gjyqësore do të duhet të pajisen me një kod identifikimi unik të çështjes gjyqësore.

Ky kod mund t’ju vihet në dispozicion në bazë të kërkesës tuaj pranë sekretareve gjyqësore të gjyqtarit të çështjes ose pranë sporteleve të Kryesekretarisë.

Kodi i jepet vetëm personave me interes të ligjshëm në proces, të parashikuar nga ligji apo aktet nën-ligjore.

Personat e jashtëm fizik apo juridik të cilët kërkojnë informacion me qëllim studimi apo praktike gjyqësore do të vazhdojnë të kenë akses mbi arkivën elektronike duke kërkuar mbi objektin e çështjeve për të cilat janë të interesuar por nuk do të kenë më mundësinë të njihen me të dhënat personale të palëve në proces në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin Jemi të hapur për sugjerime të mëtejshme.